



Nëntor 2018

MONITORIMI I STANDARDEVE TË INFRASTRUKTURËS FIZIKE TË KOPSHTeve TË SHQIPËRISË

MONITORIMI I STANDARDEVE TË INFRASTUKTURËS FIZIKE TË KOPSHTeve TË SHQIPËRISË

Faza e dytë e implementimit Nëntor 2018

Ky projekt u mbështet nga Lëviz Albania. Dhe u implementua nga “Together for Life” në bashkëpunim me Shoqatën “Engatia” dhe “Ajmi”.

Raporti u mbështet edhe nga World Forum Foundation.

Ky dokument është një raport i përgatitur për projektin “Lëviz për Kopshtin Tim”. Opinionet ose pikëpamjet e shprehura jo detyrimisht shprehin opinionet e “Lëviz Albania”.



TOGETHER
FOR LIFE



Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej përdoruesve, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e “Together for Life” si burim. Këndvështrime të autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e “Together for life”.

Grupi i monitoruesve:

- Monitoruesit nga shoqata Egnatia, për qytetin e Pogradecit:
Agim Blloshmi, Ediola Tereziu
- Monitoruesit nga shoqata Ajmi, për qytetin e Sarandës dhe Delvinës:
Shkelqim Hajno, Vasilika Ifandi, Vanesa Koka, Anxhela Lushkaj



FALENDERIME

Raporti i monitorimit të standardeve fizike të kopshteve të Shqipërisë u realizua në kuadër të vitit të dytë të implementimit të projektit “Lëviz për Kopshtin tim”, i cili u zbatua nga shoqata “Together for Life”. Ky projekt mori shkas nga nevojat e ngutshme të qytetarëve për më tepër kopshte dhe respektim të standardeve në kopshtet ekzistuese.

Monitorimi i kryer nga shoqata “Together for Life” bazohet në “Standardet e Projektimit të Kopshteve”, të hartuara nga Ministria e Zhvillimit Urban, si dhe në standardet aktuale mbi të cilat vepron Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar.

Shoqata “Together for Life” dëshiron të falënderojë gjithë stafet e kopshteve të Tiranës lidhur me dashamirësinë e shprehur dhe gatishmërinë e treguar në kohën e monitorimit të kopshteve.


Gjithashtu, një falënderim i madh shkon për Ministrinë e Arsimit dhe Bashkinë e Tiranës, për gatishmërinë e treguar në kryerjen e këtij studimi, i cili synon që të shërbejë si një pasqyrë e situatës aktuale të kopshteve në Tiranë, në mënyrë që si instancat shtetërore, ashtu edhe donatorët privatë, të mund të kontribuojnë së bashku në një përmirësim të gjendjes së kopshteve për të gjithë fëmijët e Tiranës.

Shoqata “Together for Life” shpreh falënderime për të gjithë pjesëmarrësit në këtë monitorim, për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar prej tyre në çdo fazë të monitorimit në veçanti Sonila Dubare, përfaqësuese e Liderëve Globalë, program I Eorld Forum Foundation për fëmijërinë e herëshme, për suportin në realizimin e këtij raporti.¹

¹ Projekt-aktet për vitin 2016 sipas Ministrisë së Zhvillimit Urban: http://www.zhvillimiurban.gov.al/files/news_files/Standartet__

PËRMBAJTJA

MONITORIMI FIZIK I KOPSHTVEVE TË QYTETIT TË TIRANËS.....	Faqje 4
1.1 Metodologjia e monitorimit fizik të kopshteve	Faqje 6
1.1.1 Seksioni 1: Gjeneralitete.....	Faqje 10
1.1.2 Seksioni 2: Hapësirat e brendshme.....	Faqje 16
1.1.3 Seksioni 3: Lehtësira.....	Faqje 23
1.1.4 Seksioni 4: Hapësirat e jashtme.....	Faqje 26
1.1.5 Seksioni 5: Siguria.....	Faqje 29
1.2 Konkluzione dhe Rekomandime.....	Faqje 31
Aneks: Pyetësi.....	Faqje 32
FORUMET KOMUNITARE.....	Faqje 34



Në përputhje me misionin e shoqatës “Together for Life”, ky monitorim u krye për të kuptuar situatën në të cilën ndodhen kopshtet e fëmijëve në disa qytete të Shqipërisë. Ky është një monitorim i shoqërisë civile, i pavarur dhe me qëllim përmirësimin e kushteve aktuale, duke bërë një prezantim të drejtë të gjendjes reale. Produkti final i këtij studimi është një vlerë e shtuar për të gjithë grupet e interesit.

Në këtë fazë të dytë është kryer monitorimi fizik i ambienteve të kopshteve përkatëse në disa rrethe të Shqipërisë, prej të cilave janë nxjerrë konkluzionet dhe rekomandime të cilat synojnë përmirësimin e gjendjes së evidentuar.

Përgjatë materialit lexuesit do të njihen me metodologjinë dhe kriteret e përdorura nga shoqata për vlerësimin e kushteve fizike të kopshteve të qytetit të Tiranës. Detajohen katër hapat në të cilat ka kaluar procesi i monitorimit dhe mënyra e mbledhjes së informacionit.

Për çdo të dhënë të përpunuar, prej të cilave janë nxjerrë konkluzionet e studimit, grupi monitorues ka mbajtur evidencat përkatëse. Përgjatë materialit prezantohen 5 fushat e kushteve fizike të cilat i janë nënshtruar monitorimit në të gjitha kopshtet.

Në fund jepen në formë aneksesh të dhënat tabelare mbi të cilat janë nxjerrë rezultatet dhe thenie nga intervistat me prindër.



KAPITULLI 1

MONITORIMI FIZIK I KOPSHTEVE

1. MONITORIMI FIZIK I KOPSHTEVE TË SHQIPËRISE

Procesi i monitorimit fizik ka synuar të hedhë dritë mbi kushtet në të cilat fëmijët parashkollorë kalojnë kohën e tyre gjatë ditës. Ndrzshe nga viti i kaluar, këtë vit, monitorimi ka marrë në shqyrtim 16 kopshte të qyteteve Pogradec, Ksamil, Sarandë, Delvinë. Në mënyrë qe të kemi një pamje më të qartë të situatës së kopshteve përtej kryëqytetit.

Tabela e mëposhtme prezanton listën e atyre kopshteve të marra në shqyrtim në këtë fazë të dytë të monotorimit të kopshteve, e siguruar me bashkëpunimin e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (QEZHFE) dhe organizatat lokale si: Shoqata “Egnatia” dhe Ajmi.

KOPSHTI	FREKUENCA	PERQINDJA
Delvinë	1	6%
Ksamil	3	19%
Pogradec	5	31%
Sarande	7	44%
Total	16	100%

Sic vihet re fokusi ka qënë në kopshtet e qyteteve në Jug dhe dhe Jug-lindje të vendit, nga ku janë përzgjedhur 16 kopshte

2.1 Metodologjia e monitorimit fizik të kopshteve

Së pari thoksojmë se kategorizimi i seksioneve të monitorimit fizik të kopshteve është marrë nga standardet aktuale mbi të cilat vepron Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, si dhe Standardet e Projektimit të Kopshteve, të hartuara nga Ministria e Zhvillimit Urban, të cilat kanë për qëllim që të shërbejnë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të kopshteve apo në rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese. Këto

standarde janë parashikuar si për kopshtet e sektorit publik, ashtu edhe për kopshtet e sektorit privat.

Ashtu si dhe në projektin e mëparshëm në Tiranë, procesi i monitorimit filloi me sigurimin e një lejeje monitorimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe një marrëveshjeje bashkëpunimi me të gjithë Drejtoritë Rajonale Arsimore.

Në këtë formë, edhe monitorimi fizik i kopshteve ka një emërues të përbashkët me normat që duhet të plotësojnë kopshtet e marra në shqyrtim.

Faza studimore

1. Identifikimi i treguesve kryesorë mbi të cilët do të grumbullohen të dhënat nga faza e terrenit. Për këtë janë përdorur standardet e projektimit të kopshteve, të hartuara nga Ministria e Zhvillimit Urban, të aplikueshme për të gjitha kopshtet në territorin e Shqipërisë, qofshin këto publike ose private.

2. Përzgjedhja e treguesve sasiore më kyç për sigurinë dhe mirëritjen e fëmijëve në këto ambiente, që do të përdoren për monitorimin fizik. Treguesit e përzgjedhur janë filtruar nga Standardet e Projektimit të Kopshteve, duke marrë po ashtu për secilin indikator edhe vlerat e detyrueshme sipas këtyre standardeve.

3. Përpilimi i pyetësorit që do të plotësohet nga grupet e monitoruesve.

Për të siguruar një monitorim sa më cilësor, të unifikuar dhe me instrumenta të testuar më parë, shoqata "Together for Life" organizoi më 6 shkurt trajnimin me grupin e punës monitorues të organizatave partnere në projekt: Egnatia dhe Ajmi.

4. Trajnimi i monitoruesve fizikë, duke i familjarizuar me terminologjinë, treguesit sasiore që do të kujdesen të masin, evidentimin e secilit tregues me anë të fotove, për të mbështetur me evidenca matjet e tyre, vlerat optimale që përcaktohen nga standardet për secilin tregues të marrë në shqyrtim.

Moduli i trajnimit u përgatit nga grupi i punës së shoqatës "Together for Life", i cili ishte përfshirë në monitorimin e kopshteve të qytetit të Tiranës në projektin e mëparshëm. Trajnimi njëditor shërbeu për aftësimin e personave që do të merreshin me monitorimin e kopshteve lidhur me modulet e monitorimit. Ky trajnim ishte dhe një mundësi e mirë për të rritur bashkëpunimin midis partnerëve të projektit.

Në trajnim, nga organizatat partnere morën pjesë 6 persona, ndër të cilët 2 meshkuj dhe 4 femra. Për shkak të numrit të ulët të kopshteve për secilin rreth, u mendua monitorimi me dy persona për çdo zonë (dy në Sarandë, dy në Delvinë dhe dy në Pogradec).

Krerët e organizatave bashkëpunëtoreshëbyen edhe si mbikëqyrës të këtij procesi.

- Monitoruesit nga shoqata Egnatia, për qytetin e Pogradecit:
Agim Blloshmi, Ediola Tereziu

- Monitoruesit nga shoqata Ajmi, për qytetin e Sarandës dhe Delvinës: Shkelqim Hajno, Vasilika Ifandi, Vanesa Koka, Anxhela Lushkaj

Faza e terrenit, Mbledhja e të dhënave

Për t'u realizuar monitorimi punuan 3 grupe me nga dy persona secili, përgjatë një periudhe tre mujore (përkatësisht periudhën muajt prill, maj dhe fillimi i muajit qershor).

Monitorimi i standardeve fizike të kopshteve u zhvillua në 16 kopshte. Kopshtet e monitoruara ndodhen në qytet, si dhe në fshatrat përreth. Monitorimi u realizua sipas metodologjisë dhe instrumenteve të monitorimit të standardeve fizike të kopshteve të Tiranës (referuar projektit të parë), dhe u krye nga personat e trajnuar nga shoqata "Together for Life".

Secili monitorim zgjati rreth dy orë dhe përfshiu bisedën me drejtuesit, përballjen me dokumentacionin, fotografimin e ambienteve të kopshtit dhe vëzhgim të drejtpërdrejtë të situatës në kopsht.

Ashtu si dhe në projektin e mëparshëm në Tiranë, procesi i monitorimit filloi me sigurimin e një lejeje monitorimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe një marrëveshjeje bashkëpunimi me të gjithë Drejtoritë Rajonale Arsimore.

Grumbullimi i të dhënave mbi indikatorët sasiorë është bërë nëpërmjet vëzhgimit direkt, ku për secilin rast të vëzhguar janë mbledhur foto përkatëse si evidenca për të mbështetur rezultatet e gjeneruar.

Përpunimi i të dhënave

Duke qenë se të dhënat e grumbulluara janë mbi tregues sasiorë për të cilët Standardet e Projektimit të Kopshteve kanë përcaktuar vlerat optimale për secilin prej tyre, edhe përpunimi i të dhënave është bërë për të krahasuar situatën e rezultuar nga monitorimi me normat që duhet të plotësojnë këto ambiente. Për këtë është përdorur statistika deskriptive. Pëpunimi i të dhënave është bërë me excel 2016 dhe SPSS v.22

Raportimi

Produkti final i këtij projekti është përpilimi i raportit final, ku përmbledhen të gjitha rezultatet e gjeneruara nga përpunimi i të dhënave të grumbulluara.

Monitorimi i kopshteve, analizimi i të dhënave dhe gjetjet janë grupuar sipas seksioneve të mëposhtme, në përputhje me treguesit sasiorë të Standardeve të Projektimit të Kopshteve.

1. Gjeneralitetet e kopshteve të monitoruara, në të cilin do të trajtohen të dhënat mbi kopshtet si:

- i. numrin e fëmijëve të regjistruar
- ii. sipërfaqja bruto e dyshemesë- tregues që mat hapësirën e nevojshme për qëndrimin e duhur të fëmijës në kopsht
- iii. organizimi i fëmijëve sipas grupeve
- iv. hapësirat për secilin grup fëmijësh

2. Hapësirat e brendshme dhe mobilimi minimal i nevojshëm, ku ambientet e marra në konsideratë për monitorim janë vetëm ato që ndikojnë në mirërritjen e fëmijëve, siç janë:

- i. Zyra e takimit Prind- Edukator
- ii. Infermiera/ Psikologu
- iii. Kuzhina Kryesore
- iv. Shërbimet higjienike për prindërit apo bashkëpunëtorët e tjerë
- v. Zona e pranimit
- vi. Zona aktive
- vii. Shërbimet higjienike të fëmijëve
- viii. Zona e fjetjes
- ix. Kuzhina (aneksi për shërbimin e ushqimit)
- x. Dhoma e izolimit për parandalimin e epidemive
- xi. Të tjera

3. Lehtësirat

4. Hapësira e jashtme që ndikon në:

- i. Hapësirën e lojës
- ii. Hapësirën e rrugëve lidhëse dhe parkimin për mjetet që furnizojnë kopshtet

5. Siguria, e cila shfaqet në dimensionet e mëposhtme:

- i. Sistemet e ndriçimit
- ii. Mbrojtja ndaj zjarrit
- iii. Sistemi CCTV
- iv. Njoftimi zanor

Skematikisht, si më poshtë:



1.1.1 Gjeneralitete/Të dhëna të përgjithshme

Gjetjet kryesore në seksionin e gjeneraliteteve tregojnë mbi kapacitetin e kopshteve, hapësirën shumë të vogël në dispozicion të secilit fëmijë, organizimin e fëmijëve nëpër grupe dhe numrin e edukatoreve për secilin grup fëmijësh.

Gjithsej janë marrë në shqyrtim 16 kopshte të qytetit të qyteteve në Jug dhe Jug-lindje të vendit. Sipas monitorimit rezultojnë që kopshtet të jenë ndërtuar në periudhën 1969 -2014, sipas tabelave më poshtë:


KOPSHTI	FREKUENCA	PERQINDJA
Delvine	1	6%
Ksamil	3	19%
Pogradec	5	31%
Sarande	7	44%
Total	16	100%

Monitorimi i standardeve të infrastrukturës fizike të kopshteve, nëntor 2018

Viti I ndertimit	Frequency	Percent
1969	1	6.3
1973	1	6.3
1988	2	12.5
2014	1	6.3
Total	5	31.3
Pa pergjigje	11	68.8
	16	100.0


Prej këtyre 16 kopshteve, në kohën e realizimit të monitorimit tetë kopshte figurojnë të rikonstruara. Nga të cilët 1 prej tyre para vitit 2000 dhe 8 të tjerë ne periudhën 2001-2017. Sipas të dhënave të mbledhura, vetëm 4 prej kopshteve rezultojnë të rikonstruara pas vitit 2010.

Viti I Rikonstruktimit	Frequency	Percent
1997	1	6%
2001	1	6%
2008	3	19%
2010	1	6%
2014	1	6%
2015	2	13%
2017	1	6%
Total	10	63%
Pa riskostruara	6	38%



Rikonstruktimet në shumicën e rasteve rezultojnë të kënë qënë të pjesshme si për shembull, rikonstruktimit solete, lysterje etj. Vlen të theksohet se disa prej kopshteve ende të parikonstruara janë tanimë shumë të hershëm, psh rasti i kopshtit në Delvinë, i cili është ndërtuar në vitin 1969.

Përshkrimi	vlera
Kopshtet e monitoruara	16
Kopshte me të dhëna mbi sipërfaqen e shfrytëzueshme	12
Kopshte me fëmijë përtej vlerave normale	0
Kopshte me fëmijë / sipërfaqen minimale	1 (6%)
pa të dhëna	4
hapësirë më e vogël se 7m2/ fëmijë	11 (69%)
hapësirë brenda normave	1 (6%)
kanë hapësirë më të madhe se vlerat normale	1 (6%)



Bazuar në Standardet e Projektimit të Kopshteve, grupet e fëmijëve nëpër kopshte janë 3, ku:

Grupi i I-rë

Janë fëmijë të moshës 3-4 vjeç. Grupe të tilla, bazuar në Standardet e Projektimit të Kopshteve, duhet të jenë maksimalisht prej 15 fëmijësh.

Grupi i II-të

Në këto grupe janë fëmijë të moshës 4-5 vjeç. Sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve, numri maksimal i fëmijëve në këto grupe duhet të jetë 25 fëmijë.

Grupi i III-të

Në këto grupe janë fëmijë të moshës 5-6 vjeç. Sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve, numri maksimal i fëmijëve në këto grupe duhet të jetë 30 fëmijë.

E rëndësishme është që, sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve, nuk duhet të ketë grupe me mosha të përziera. Secili fëmijë duhet të vendoset në grupin ku përket sipas grupmoshës.


Gjatë monitorimit u vu re se:

- Gjatë analizës së monitorimit u vu re se numri i fëmijëve të regjistruar në 5 prej kopshteve të marra në shtyrim ishte rreth 20-30 % më i madh se numri i kapacitetit kopshtit. Pjesa tjetër e kopshteve kishin numër brenda normave të lejuara të standardeve dhe konsideruar kapacitetin e kopshtit.
- Në total vlera mesatare e kapacitetit të kopshteve të monitoruara ishte 71.4 fëmijë për kopsht, ndërkohë që vlera mesatare e fëmijëve të regjistruar ishte 73.1 fëmijë për kopsht. Pra, mesatarisht kopshtet në këto zona kanë 2.4 % fëmijë më shumë se kapaciteti i kopshteve.
- Të ndarë sipas grupeve, për grupet e para, të cilat përbëhen nga fëmijë të moshave 3-4 vjeç, nuk është respektuar numri maksimal i fëmijëve që duhet të përmbajë grupi, bazuar në Standardet e Projektimit të Kopshteve. Në 6 nga kopshtet prej të cilave u grumbulluan të dhëna nuk u gjet të ishte respektuar numri maksimal prej 15 fëmijësh në grupin e parë. Numri arrinte deri nga 19 në 27 për grup. Vlera mesatare e fëmijëve në grupet e para është 17.9, kjo pasi shumë prej kopshteve kanë numër shumë më të vogël se 15 (8, 12, 14 fëmijë) duke e ulur vlerën mesatare të fëmijëve për grup. Por nëse studiojmë Modën e vlerave, ajo është 21 fëmijë për grup.
- Edhe në 2 grupet e tjera më të rritura ka disa raste me mbi 25 fëmijë në grup, por në përgjithësi nuk është problem.
- Gjatë monitorimit vihet re se, në grupet e para mosha e fëmijëve që marrin pjesë nuk është gjithmonë homogjene. Në 4 nga 16 kopshtet, programi zhvillohet i përzierë midis 3 grupeve bashkë. Në 4 prej kopshteve, fëmijët e grupmoshës të 3-4 vjeç janë të përzierë të dy grupet e tjera më të rritura. Dhe në 2 prej kopshteve, fëmijët e grupmoshës të 3-4 vjeç janë të përzierë dhe zhvillojnë programin ditë bashkë me fëmijët e grupit të dytë.
- Po ashtu, në grupet e dyta të 5 prej kopshteve të marra në vëzhgim u vërejt se ka fëmijë jashtë grupmoshës 4-5 vjeç.


- Kjo patjetër që çënon shumë mbarëvajtjen e programit ditor dhe ndikon në zhvillimin kognitiv, fizik dhe emocional të fëmijëve.
- 2 prej kopshteve që kane grup fëmijësh 4-5 vjec, nuk kanë edukatore të dedikuar për këtë grupmoshë dhe mësimi zhvillohet bashkë me grupin 1 me 1 edukatore.
- Asnjë prej 12 kopshteve që kanë deklaruar SBD, nuk përmbush minimumin e standardit 7 m² për fëmijë. Mesatarja e SBD në këto kopshte është 3.96 m² për fëmijë.
- Në grupet e dyta, ku bëjnë pjesë fëmijë të moshës 4-5 vjeç, në rastet kur info është siguruar, vihet re fenomeni i mbi-kapaciteteve të hapësirave. Teë paktën 8 (50% të kopshteve të monitoruara) vihet re një numër fëmijësh për grup përtej normave të këshilluara për mirërritjen e tyre.
- Për me tepër, kapacitetet e hapësiave në keto kopshte me grupe mikse, janë tej mase nën normat e përcaktuara në Standardet e Projektimit të Kopshteve, duke shënuar vlera si 0,4 m², 3m², 4.0 m², 4.7 m² etj. në 11 nga 16 prej kopshteve të monitoruara. Përmendim kopshtin Metoq, Sarandë, Rruga Rruga Zenel Poci, ku mesimi i 24 fëmijëve të grupmoshave të ndyshme, zhvillohet në një grup të vetëm, me një edukatore dhe në një ambient me 3,75 m² për fëmijë. Në kushte të vështira është edhe kopshti Bakaj, Delvinë, I ndertuar që në 1969, I pa rikonstruktuar; ku program për 20 fëmijët zhvillohet në një ambient 4,5 m² për fëmijë, në një klasë të vetme, me 1 edukatore dhe me 33% fëmijë mbi kapacitet.

Tabelë Përmbledhëse: Përmbledhje e gjetjeve mbi gjeneralitetet për të tre grupet e fëmijëve në kopshtet e monitoruara sipas indikatorëve përkatës:

Indikator	Vlerat nominale		
	Të dhëna mbi Grupet e I-ra (3-4 vjeç)	Të dhëna mbi Grupet e II-ta (4-5vjeç)	Të dhëna mbi Grupet e III-ta (5-6 vjeç)
Nr. i kopshteve të monitoruar	16	16	16
Nr. i kopshteve me të dhëna	16	16	16
Nr i fëmijëve për grup mbi standard	6	3	0
Grupe me mosha jo homogjene	6	6	4



Sa i përket numrit të fëmijëve për edukatore është përkatësisht 17.9, 20.3, 22 për grupet 1, 2 dhe 3. Ku mesatarisht rezultojn të kemi 1 edukatore për 20.1 fëmijë. Kjo shifër është më kënaqshme krahasuar me vlerat e monitorimit në kopshtet e Tiranës (24.2), por gjithësesi mbetet më e larta në Europë e rajon. Më poshtë, në formë grafike, paraqiten rezultatet e këtij raporti në vendet të Europës dhe të rajonit.



Sic vihet re se, mesatarisht, edukatoret e ciklit parashkollor në qytetin e Tiranës kanë dyfishin ose më shumë e fëmijëve nga çfarë kanë koleget e tyre në Greqi, Rumani, etj.²

Gjithashtu vihet re se kopshtet në rrethet e vëzhguara janë në një situatë më të mirë sa i përket numrit të fëmijëve për edukatore krahasuar me kryeqytetin, me mesatarisht 4 fëmijë më pak në grup krahasuar me Tiranën.

1.1.2 Hapësirat e brendshme

Hapësirat e brendshme kanë një fokus të veçantë në Standardet e monitorimit të kopshteve, me numrin më të madh të indikatorëve të përcaktuar dhe të mundshëm për tu monitoruar.

Nga monitorimi i kopshteve të Tiranës u përpunuan të dhënat e mëposhtme, të cilat janë grupuar sipas nënkategorive përkatëse.

1. Zyra e takimit prind – edukatore (vetëm 3 kopshte, (19% e kanë këtë zyrë, nga kopshtet e monitoruara).
Zyra e takimit prind-edukator, e cila duhet të jetë një dhomë e veçantë, nuk ekziston përpjesën më të madhe të kopshteve. Vetëm 19% e kopshteve të monitoruara e kanë këtë dhomë.
2. Sa i përket Dhomës së çlodhjes (si ambient i ndarë, 2m²/ fëmijë) vetëm 4 prej kopsheve kanë. Pra, vetëm 25% e kopshteve të monitoruara.
3. Sa i përket psikologut, 12 prej kopshteve e kanë, pra 75% e kopshteve.
4. Sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve, një kopsht duhet të ketë edhe një dhomë infermierie dhe një zyrë psikologu. Infermieria nuk është e pranishme në asnjë prej kopshteve.
5. Sa i përket mjeteve elektronike, vetëm 1 prej kopshteve rezulton te ketë Kompjuter, printer, projektor.

² **Tabela e mësipërme është hartuar me të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Eurostat për periudhën e vitit 2014. <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3217494/5785249/EC-01-14-484-EN.PDF/cbdf1804-a139-43a9-b8f1-ca5223eea2a1>

Monitorimi i standardeve të infrastrukturës fizike të kopshteve, nëntor 2018

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Hapësirat për grupet		10	63%	6	38%	0	16
Dhomë loje dhe ushqimi	3m2/ fëmijë	11	69%	5	31%	0	16
Dhomë çlodhje (ambient i ndarë)	2m2/ fëmijë	4	25%	12	75%	0	16
Shërbime Higjienike, Tualete	1m2/ fëmijë	16	100%	0	0%	0	16
Zyra e takimit Prind / Edukatore	12-18m2/ kopësht (75-125 fëmijë)	3	19%	13	81%	0	16
Tavolinë	1	14	88%	2	13%	0	16
Karrike	4	14	88%	2	13%	0	16
Dollap i madh	1	6	38%	10	63%	0	16
Dollap i vogël	1	8	50%	8	50%	0	16
Kompjuter	1	1	6%	15	94%	0	16
Printer	1	1	6%	15	94%	0	16
Projektor	1	0	0%	16	100%	0	16
Gjerësia e dhomës	minimalisht 3m	11	69%	0	0%	5	16
Infiermeria	9 - 12m2	0	0%	16	100%	0	16
Psikologu	9 m2	12	75%	4	25%	0	16
Dollap i madh	1	4	25%	11	69%	1	16
Tavolinë pune	1	10	63%	5	31%	1	16
Frigorifer për medikamente	1	0	0%	15	94%	1	16
Karrike	1	9	56%	6	38%	1	16
Dollap i vogël	1	5	31%	10	63%	1	16
Lavaman	1	7	44%	7	44%	2	16
PC	1	0	0%	13	81%	3	16
Printer	1	0	0%	15	94%	1	16
Aparat dezinfektimi	1	2	13%	13	81%	1	16
Krevat për vizita	1	0	0%	15	94%	1	16
Gjerësia e dhomës	minimalisht 3m	5	31%	10	63%	1	16

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Kuzhina Kryesore	24 - 30 m²	5	31%	9	56%	2	16
Njësi gatimi	1	5	31%	10	63%	1	16
Frigorifer	1	4	25%	11	69%	1	16
Lavastovilje	1	1	6%	14	88%	1	16
Lavaman	1	6	38%	9	56%	1	16
Suprinë me dollapë	1	4	25%	11	69%	1	16
Aspirator	1	4	25%	11	69%	1	16
Dollap (0.4x1.6x2.2) m	1	2	13%	13	81%	1	16
Dhomë frigoriferike 2x2m	1	1	6%	14	88%	1	16
Vend për shpërndarjen e ushqimit	1	3	19%	12	75%	1	16
Shërbime Higjenike (për prindërit, bashkëpunëtorët, etj)	9 m²	3	19%	11	69%	2	16
WC	2	10	63%	4	25%	2	16
Lavaman	2	11	69%	4	25%	1	16


1. Kuzhina kryesore, vetëm 5 nga 16, 31% e kopshteve të monitoruara, e kanë këtë hapësirë/ Kryesisht kopshtet e lokalizuara ne qytet.
2. Dhoma frigoriferike ishte vetëm në 3 kopshte
3. Vetëm 1 kopsht ka lavastovilje në kuzhinë për larjen e enëve.
4. Pajisja e frigoriferit nuk u gjet vetëm në 4 kopshte.
5. 15 kopshte nuk kanë lavaman në kuzhinën kryesore.
6. Aspiratori mungon në 11 (69%) kopshte .
7. Vendi i dedikuar për shpërndarjen e ushqimit, u vu re vetem ne 3 kopshte (19%)

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Zona e Pranimit	min 7.5 m2	4	25%	10	63%	2	16
Dollape me module	min 5 copë	2	13%	13	81%	1	16
Dollape me varje me modul	min 5 copë	4	25%	11	69%	1	16
Zona aktive (Loja dhe Ushqimi)	min 45m2	9	56%	6	38%	1	16
tavolinë ushqimi	1 / 4 fëmijë	4	25%	11	69%	1	16
tavolina didaktike (1.2x0.7x0.35)m	2	7	44%	6	38%	3	16
karrike druri	2/ fëmijë	14	88%	1	6%	1	16
Dollapë	3	10	63%	4	25%	2	16
tapet sfungjeri me ngjyra	4 m2	5	31%	10	63%	1	16
Karrike për mësuesit	për çdo mësues	14	88%	1	6%	1	16
teatri (2x0.7x2.1) m	1	2	13%	13	81%	1	16
Gjerësia e dhomës	minimalisht 5m	9	56%	6	38%	1	16

Zona Aktive (të gjitha kopshtet e kanë zonën aktive).

- 6 kopshte nuk kanë fare tavolinë didaktike për fëmijët
- 13 kopshte (81%), nuk kanë dollapë me module për mjetet e fëmijëve, lodrat apo librat e tyre në zonën aktive.
- 10 kopshte nga 16 (63%) nuk kanë tapetat e sfungjerit me ngjyra, të rekomanduara si mjetet minimale të nevojshme nga Standardet e Projektimit të Kopshteve.
- Vetëm 2 kopshte kanë teatër për fëmijët e tyre.
- 14 prej kopshteve raportojnë se kanë karrige druri për fëmijët.

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Zona e Fjetjes	min 30 m2	3	19%	12	75%	1	16
Tavolinë	1	5	31%	9	56%	2	16
Dollap	1	4	25%	11	69%	1	16
Kreatë pa parapet (1.25x0.65x0.26)m	12	0	0%	13	81%	3	16
largësia e krevatëve në anë të tjetrit	0.5 m	1	6%	14	88%	1	16
Largësia e krevatëve përballë njëri -tjetrit	0.6 m	1	6%	14	88%	1	16
Gjerësia e dhomës	minimalisht 3.5m	5	31%	9	56%	2	16
Lidhje direkte me dhomën e ushqimit (Zonën aktive)	po	1	6%	14	88%	1	16



Zona e fjetjes (vetëm 3, (19%) e kopshteve e kanë këtë hapësirë.

- Vetëm 7 kopshte (nga të cilat vetëm 4 janë të nismës “Adopto një kopsht”) kanë tavolinë në zonën e fjetjes.

- 12 kopshte (nga të cilat 11 janë të nismës “Adopto një kopsht”) kanë dollap në këtë zonë.
- 13 kopshtet (81%) janë pa krevate fare, dhe për 3 prej kopshteve nuk disponojmë informacion.
- 14 kopshtet (88%) me zonë fjetje dhe me krevate i kanë shtretërit e ngjitur pas njëri-tjetrit, duke mos respektuar hapësirën minimale të nevojshme mes shtretërve, 0.5 m.

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Shërbimet higjienike të fëmijëve (tualetet)	min 15m2	12	75%	3	19%	1	16
WC	1/ fëmijë	8	50%	7	44%	1	16
Lavaman	1/ fëmijë	8	50%	6	38%	2	16
Dollap	1	5	31%	9	56%	2	16
Lavaman i thellë për larjen e fëmijëve të grupit të I-rë	1	1	6%	14	88%	1	16
Thellësia e lavamanit për larjen e fëmijëve të grupit të I-rë	0.3m	0	0%	14	88%	2	16
Lavaman për të rritur	1	6	38%	8	50%	2	16
Dollap i sipërm	1	2	13%	13	81%	1	16

- Shërbimet higjienike për fëmijë janë të pranishme në 12 (75%) e të gjitha kopshteve të monitoruara. Ato i kanë shërbimet higjienike për fëmijë
- Gjysma e kopshteve nuk disponon WC për fëmijët. Ata përdornin ambientet e shkollave etj.
- Lavamani i thellë për larjen e fëmijëve 3-vjeçarë, nuk u gjet asnjë kopsht, vetëm në një kopsht dispononin një vaske.

Kuzhina: Vihet re se vetëm rreth 20% e kopshteve e plotësojnë standardin për aneks në zonën e kuzhines për shërbimin e ushqimit duke patur parasysh pajisjen me frigoriferë, lavamanë, pianure, dollap etj.

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Kuzhina - Aneks për shërbimin e ushqimit	min 7.5 m2						
		3	19%	12	75%	1	16
Tavolinë (0.6x0.6x0.8)m	1	3	19%	12	75%	1	16
Dollap	1	3	19%	11	69%	2	16
Frigorifer	1	4	25%	11	69%	1	16
Lavaman	1	2	13%	11	69%	1	14
Pianurë elektrike me dy vatra	1	0	0%	15	94%	1	16
Mikrovalë	1	1	6%	14	88%	1	16
Gatuhet ushqim?	jo	4	25%	11	69%	1	16
Ngrohet ushqim?	po	0	0%	14	88%	2	16
Si ngrohet ushqimi?	mikrovalë	0	0%	14	88%	2	16

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Dhoma e Izolimit (në rast sëmundjesh)	6- 10m2						
		0	0%	15	94%	1	16
Tavolinë	1	4	25%	10	63%	2	16
Karrike	1	6	38%	9	56%	1	16
Kolltuk	1	0	0%	15	94%	1	16
Dollap i madh	1	5	31%	10	63%	1	16
Dollap i vogël	1	5	31%	10	63%	1	16
Lavaman	1	5	31%	10	63%	1	16
PC	1	0	0%	15	94%	1	16
Printer	1	0	0%	15	94%	1	16
Frigorifer	1	2	13%	13	81%	1	16
Aparat dezinfektimi	1	0	0%	15	94%	1	16
Krevat për vizita	1	0	0%	15	94%	1	16
Gjerësia e dhomës	minimalisht 2.5m	8	50%	7	44%	1	16

Asnjë prej kopshteve nuk ka dhomë izolimi, në raste sëmundjesh apo epidemish në kopëesht.

Gjithashtu asnjë prej kopshteve nuk disponon printer ose pc, aparat desinfektimi apo krevat për vizita.

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Të tjera		0	0%	4	25%	1	5
- tavolina me kënde të zmusuara (me diametër 0 më pak se 13mm);	po	1	6%	14	88%	1	16
- ulëse të përshtatshme për moshën me mbështetëse dhe ndenjëse në formë anatomike;	po	3	19%	12	75%	1	16
- dollape të vegjël, lehtësisht të aksesueshëm nga të vegjlit për të depozituar gjërat e tyre personale, lodrat dhe materialet didaktike	po	12	75%	3	19%	1	16
Objekte që përbëjnë rrezikshmëri, janë larg fëmijëve, nuk arrihen nga fëmijët	po	15	94%	0	0%	1	16
- Akses i brendshëm për lëvizjen e personave/ fëmijëve PAK	po	0	0%	14	88%	2	16

- Vetëm 1 kopsht ka tavolina me cepa dhe kënde të pazmusuara; gjithë të tjerët nuk kanë.


1.1.3 Lehtësira

Problematikat e identifikuara në seksionin e Lehtësitave kanë të bëjnë me disa aspekte të kushteve fizike që ofrojnë kopshtet e qytetit përkatëse për fëmijët parashkollorë përtej atyre të

lartpërmendura , si uji i rrjedhshëm, uji i ngrohtë dhe i ftohtë, sistemi ngrohje-ftohje i ambienteve të brendshme etj.

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Fasilitete të brendshme		2	13%	4	25%	1	7
Energji Elektrike pa ndërprerje	po	14	88%	1	6%	1	16
Ngrohje dhe Ftohje për temperaturë konstante	po	6	38%	9	56%	1	16
H2O i rrjedhshëm dhe pa ndërprerje	po	10	63%	5	31%	1	16
H2O i ngrohtë dhe i ftohtë pa ndërprerje	po	2	13%	13	81%	1	16
Depozitë uji kur mungon furnizimi i linjës	po	7	44%	8	50%	1	16
TV satelitor/ tokësor në ambientet e qëndrimit të fëmijëve	po	1	6%	14	88%	1	16
TV satelitor/ tokësor në dhomat e argëtimit të fëmijëve	po	1	6%	14	88%	1	16

1. Kopshtet here pas here kanë probleme me energjinë elektrike,
2. Vetëm 38% e kopshteve të qytetit të monitoruara kanë një formë ngrohje për mbajtjen e temperaturës konstante në ambientet e tyre. Vetëm 1 prej tyre ka sistem ftohje (kondicioner)
3. Rreth 745 (nga 1170 nga totali) fëmijët të 9 prej kopshteve të monitoruara nuk kanë në ambientet e tyre as ngrohje e as ftohje.
4. 81% e kopshteve të qytetit të Tiranës nuk kanë ujë të ngrohtë dhe të ftohtë pa ndërprerje. Vlen të theksohet se në 50% të kopshteve mungojnë edhe depozitat e ujit.
5. 50 % të kopshteve të monitoruara, nuk kanë depozitë uji për të siguruar vazhdimësi në higjienën e fëmijëve dhe të vetë institucionit.
6. 88% e kopshteve, nuk kanë asnjë TV satelitor apo tokësor në ambientet e qëndrimit të fëmijëve.



1.1.4 Hapësira e jashtme

Seksioni “Hapësirat e jashtme” e vendos vëmendjen në ato aspekte të cilat shoqërojnë mirëritjen e fëmijëve, siç janë: hapësirat për aktivitetet argëtuese dhe hapësirat e mjediseve përreth godinës për aktivitetin e përditshëm operacional të një institucioni përkujdesës.

Në pjesën e parë të këtij seksioni janë trajtuar evidencat e identifikuara gjatë monitorimit të hapësirave të lojërave për fëmijët.

Gjatë monitorimit u vunë re gjetjet e mëposhtme:

1. 50 % e kopshteve të monitoruara nuk kanë mure ndarëse për të kufizuar ambientet e tyre të jashtme, ashtu siç kërkohet nga Standardet e Projektimit të Kopshteve.
2. 3 nga 16 kopshtet e monitoruara nuk kanë lodra në ambientet e tyre të jashtme për fëmijët ose nuk kanë lodra të pamjaftueshme për numrin e fëmijëve të pranishëm në institucion.
3. 50% nga kopshtet e monitoruara nuk kanë gjelbërim dhe bimësi të shkurtër në mjediset e lojërave.
4. 50% e kopshteve kanë lodra me te cilat nuk mund të luhet në hije. (lodra të pa lëvizshme)
5. Vetëm 25% e kopshteve kanë stola për fëmijë në hapësirat e jashtme.

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Hapësira e Lojës							
Rrethohet me mure ndarëse	po	7	44%	8	50%	1	16
Ka lodra	po	12	75%	3	19%	1	16
Oborri është i mbuluar me gjelbërim dhe bimë të shkrutra 0.4m	po	6	38%	9	56%	1	16
Stola për fëmijët për të pushuar apo qëndruar	po	4	25%	11	69%	1	16
25% e lojrave në oborr mund të luhen në hije	po	7	44%	8	50%	1	16
Hapësira e Rrugëve lidhëse dhe Parkimit		1	6%	12	75%	3	16
Akses për makinat që furnizojnë kopshtin me materiale	po	2	13%	13	81%	1	16
Akses i karrocave të fëmijëve	po	0	0%	15	94%	1	16

Sa i përket hapësirave për rrugët lidhëse me institucionin dhe parkimin brenda mjediseve të tij.

Nga të dhënat e marra nga kopshtet e monitoruara, vihen re se:

1. 81% e kopshteve të qytetit të Tiranës nuk ofrojnë akses për makinat që furnizojnë kopshtin me materiale të ndryshme.
2. 94 % e kopshteve të qytetit të Tiranës të monitoruara nuk ofrojnë akses për karrocet e fëmijëve dhe për personat me aftësi të kufizuara (rampa, etj)

1.1.5 Siguria


Siguria që ofrojnë kopshtet e monitoruara si institucione të mirërritjes së fëmijëve parashkollore është trajtuar në disa aspekte: Sistemi i ndricimit, Mbrojtja kundër zjarrit dhe Sistemi CCTV he

Gjetjet e identifikuar gjatë procesit të monitorimit u përmbledhën në tabelat e mëposhtme:

Sistemi i ndricimit:

1. 88% e kopshteve të qyteteve të monitoruara nuk kanë sistem ndriçimi emergjence.
2. Asnjë kopësht nuk ka gjeneratorë për të siguruar ndriçimin alternativ.
3. Të gjitha kopshtet e monitoruara rezultojnë pa sistem ndriçimi për evakuim.
4. Asnjë nga kopshtet e monitoruara nuk ka kontraste kromatike në dysheme për të treguar drejtimin e evakuimit.
5. Vetëm 1 kopësht ka dalje sigurie por vetëm në 1 korridor
6. Asnjë kopësht nuk kanë sinjalistikë që të të udhëheqë drejt daljeve të emergjencës.

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Sistemi i ndriçimit							
A ka sistem ndricimi emergjence?	po	1	6%	14	88%	1	16
A ka gjenerator për ta siguruar gjithmonë ndriçimin alternativ?	po	0	0%	15	94%	1	16
Sistem ndriçimi evakuimi? (sinjalistika për evakuim e ndriçuar)	po	0	0%	15	94%	1	16
Kontraste kromatike në dysheme për të treguar drejtimin e evakuimit?	po	0	0%	15	94%	1	16
Dalje sigurie në holl dhe korridoret?	po	1	6%	14	88%	1	16
Dalje emergjente ka në secilin korridor?	2	0	0%	15	94%	1	16
A ka sinjalistikë për daljet e emergjencës?	po	0	0%	15	94%	1	16



Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Mbrojtja kundër zjarrit		3	19%	10	63%	3	16
Dritaret janë pa skara hekuri	po	6	38%	9	56%	1	16
Hapja e dyerve bëhet nga Brenda - Jashtë	po	3	19%	12	75%	1	16
Gjatësia e korridorëve të daljes	< 23 m	0	0%	13	81%	3	16
Gjatësia e korridoreve pa dalje	< 6.1 m	2	13%	10	63%	4	16
Tabela për shpjegimin e ngjyrave sipas nivelit të rrezikut? (E kuqe, E verdhë/ Portokalli, Bojëqielli, E gjelbër)	po	4	25%	11	69%	1	16
Sistem detektimi i zjarrit	po	1	6%	14	88%	1	16
Sirenat e zjarrit	po	0	0%	15	94%	1	16
Impiante për shuarjen e zjarrit	po	4	25%	10	63%	2	16
Dinë edukatorët si t'i përdorin në rast zjarri?	po	2	13%	13	81%	1	16

Mbrojtja kundër Zjarrit:

1. Janë 63% kopshte të monitoruara që dritaret i kanë të mbyllura me kangjella hekuri. Duke vënë kështu në rrezik jetën e fëmijëve. Dritaret duhet të jene pa skara hekuri, për ti dhënë mundësi shpëtimi në rast zjarri.
2. 75 % e kopshteve i kanë dyert që hapen në drejtimin “brenda - jashtë”, duke vështirësuar daljet emergjente në situatë zjarri.
3. Në 69 % të kopshteve të mungojnë tabela shpjeguese për ngjyrat që paralajmërojnë rrezikun.
4. 14 nga 16 kopshtet e monitoruara nuk kanë sistem detektimi të zjarrit.
5. Asnjë kopsht nuk ka sirena alarmi për lajmërimin e ndonjë zjarri të mundshëm.
6. Vetëm në 2 kopshte rezulton se edukatorët dinë si të përdorin mjetet emergjente për shuarjen e zjarrit.

Sistemi CCTV dhe Njoftimi Zanor

Gjatë monitorimit të seksionit të sigurisë, është i rëndësishëm edhe monitorimi i kamerave të sigurisë dhe njoftimit zanor.

Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Sistemi CCTV		0	0%	14	88%	2	16
Dhomë serveri ku të jetë i vendosur sistemi CCTV	po	0	0%	14	88%	2	16
Kamera sigurie në secilën dhomë dhe ambient	po	0	0%	14	88%	2	16
Kamera në hyrje të kopshtit	po	0	0%	14	88%	2	16
Njoftimi Zanor		0	0%	14	88%	2	16
Altoparlantë në korridore	po	0	0%	15	94%	1	16
Altoparlantë në ambientet e përbashkëta (klasa, dhoma fjetje, etj)	po	0	0%	15	94%	1	16


Nga monitorimi u vu re se:

1. Asnjë prej kopshteve të monitoruara, nuk ka dhomën e serverit ku është i vendosur sistemi CCTV. Kopshtet janë pa kamera sigurie, dhe që nuk sigurojnë informacion të rrjedhshëm, pa altoparlante, dhe pa dhomë serveri.

1.1.6 Higjena

Kryesisht raportohen arritje të mira kundrejt indikatorëve të higjenës.

Gjithësesi ende në disa kopshte raportohen mungesa në sete higjene dhe sapunë dhe peshqirë në secilin lavaman mungojnë në 25% të kopshteve. Gjithashtu mungojnë planet ditore për larjen e tualeteve.



Indikarët	Standardi minimal	Po		Jo		Pa përgjigje	Total
		Nr kopshtesh	%	Nr kopshtesh	%		
Higjiena e institucionit		0	0%	0	0%	16	16
Ambientet e brendshme ajrosen	po	16	100%	0	0%	0	16
Dezinfektimi i ambienteve të kopshtit	1-2 herë në vit	13	81%	3	19%	0	16
Ambientet e kopshtit janë të pastruara para ardhjes në mëngjes të fëmijëve	po	16	100%	0	0%	0	16
Ambientet e kopshtit pastrohen pas largimit të fëmijëve	po	16	100%	0	0%	0	16
Ka plane javore për pastrimin e plotë të ambienteve të kopshtit	po	4	25%	11	69%	1	16
Kuzhina është e pastër	po	2	13%	2	13%	12	16
Enët e gatimit dhe të ngrënies lahen me ujë të ngrohtë pas ngrënies	po	14	88%	2	13%	0	16
Fëmijët përdorin enë (pjata, lugë pirunj) të larë	po	14	88%	2	13%	0	16
Ambienti i dhomës së argëtimit është i pastër dhe i rregullt	po	13	81%	3	19%	0	16
Çarçafët, bataniet dhe Organët janë të pastër	po	3	19%	2	13%	10	15
Plane javore për larjen e çarçafëve, peshqirëve, etj	po	3	19%	1	6%	11	15
Tualetet (WC dhe Lavamanët) janë të pastra dhe të dezinfektuara	po	16	100%	0	0%	0	16
Plane ditore për larjen e tualeteve	po	1	6%	15	94%	0	16
Ka sapun dhe peshqirë në secilin lavaman	po	12	75%	4	25%		16
Ka peshqirë të pastër në secilin lavaman	po	8	50%	8	50%		16

1.2 Konkluzione dhe Rekomandime

Prej monitorimit të kopshteve në qytetet Sarandë, Pogradec, Dlevinë, Ksamil, vihen re se fëmijët hasem me 2 probleme kryesore:

problemet e evidentuar përgjatë seksioneve të mësipërme vijnë si pasojë e dy shkaqeve kryesore:

- I. Numrin e lartë të fëmijëve të regjistruar për hapësirat që ofrojnë kopshtet. Monitorimi na tregon për mungesë të hapësirave të nevojshme për mirërritjen e fëmijëve në kopshtet, mungese edukatores apo staf ndihmes, si edhe grupe mikse.

Shtimi ambienteve dhe zgjerimi i kopshteve aktuale, si edhe pajisja me më shumë mjete didaktike dhe fizike të nevojshme për mbarëvajtjen e planit të zhvillimit e mirërritjes së femijeve, do të kontribuojë, në:

1. Uljen e dendësisë së fëmijëve nëpër grupe;
2. Homogjenitetin e grupeve të fëmijëve duke e bërë më të lehtë arritjen e planit ditor ne bazë të grup-moshave.
3. Uljen e raportit fëmijë/edukator për të qenë sa më pranë raportit që përdorin vendet fqinje dhe ato të rajonit;
4. Uljen e numrit të shtretërve për secilin grup, duke bërë të mundur respektimin e hapësirave të nevojshme sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve;
5. Plotësimin e mjeteve të nevojshme të kopshteve sipas mungesave që has stafi si pasojë e mbipopullimit;
6. Kryerjen e vizitave e proceseve parandaluese dhe një marrëdhënie më të ngushtë me prinderit, duke shtuar e dhomën e takimit prind/edukator, dhomës së psikologut dhe të infermierisë për të gjitha kopshtet.

- II. Mungesa e monitorimit të vazhdueshëm të kopshteve. Raportim i situates Një katalizator i rëndësishëm i ofrimit të një shërbimi cilësor, të krahasueshëm me standardet e projektimit të kopshteve, është sistemi i kontrollit të brendshëm. Një sistem i efektshëm kontrolli i brendshëm garanton përmiresim të cilësisë së shërbimit dhe adresimin në kohë të problemeve të konstatuara. Prandaj, monitorime të shpeshta, periodike dhe të mirëplanifikuara për të gjitha ambientet e kopshteve janë jetike në garantimin e shërbimit. Shumë probleme të mungesave të shumta në pajisje, mjete pune apo mësimore, cilësinë e stafit, apo edhe vetë higjienën e ambienteve të brendshme e të jashtme, mund të minimizohen prej sisteme efektive të kontrollit të brendshëm.


- III. Pajisja me mjete didaktike e lojëra zhvilluese për fëmijët
- IV. Advokim për sistemimin dhe kthimin në funksionalitet të ambienteve të jashtme të kopshteve
- V. Pajisja me minimumin e standardeve të sigurisë
- VI. Trajnime për stafin për përdorimin e sistemeve të sigurisë dhe sistemeve të tjera ndihmëse në kopsht.
- VII. Vënia në punë e dhomës së infermjerës dhe psikologes dhe ndjekja e procesit të monitorimit, (parandalimin shëndetësor, depistim, vizitat rutinë monitoruese por jo vetëm) në mënyrë që të diagnostikohen, parandalohen dhe raportohen në kohë, raste të mundshme sëmundjesh, stresi toksik, rastet e abuzimit, neglizhencës apo epidemish në këtë grup-moshë
- VIII. Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare në 100% të rasteve
- IX. Pajisja me dhomë izolimi
- X. Pajisja me të paktën 1 kompjuter dhe printer për çdo kopsht, në mënyrë që të ruhen në databaza të posaçme, vijueshmëria dhe progresi i fëmijëve gjatë gjithë periudhës së kopshtit.

Aneksë:

Në dokumentin Excel të bashkangjitur janë të gjitha databazat, kodimet dhe analiyat e nevojshme për këtë raport:



database_derguar
nga TFL_31_october.



KAPITULLI 3

FORUMET KOMUNITARE

TRAJNIME ME PRINDER



Përgjatë gjithë projektit u zhvilluan 9 diskutime te hapura, ndër të cilat 3 në Sarandë dhe Delvinë, 3 në Pogradec, 3 në Tiranë. Gjithashtu u zhvilluan 3 takime me anëtarët e Bordeve të prindërve të kopshteve të Tiranës si dhe një trajnim me anëtarë të bordeve. Nga këto aktivitete përfituan fëmijët e kopshteve të Tiranës, Pogradecit, Sarandës dhe Delvinës.

Nga diskutimet e hapura në Ksamil dhe Pogradec, pati menjëherë reagime nga pushteti vendor dhe kjo konsiderohet si histori suksesi për shoqatën Together for Life dhe partnerët zbatues.

KSAMIL

Pas tryezës frytdhënëse të pak kohëve më parë organizuar në Ksamil me komunitetin e prindërve dhe drejtues të Njesisë Administrative, në kuadër të projektit të mësipërm, patëm rastin të bashkëbisedojmë me administratoren e Ksamilit znj. Valbona Oruçi e cila vjen nga një stazh i gjatë në sektorin e arsimit si mësuese dhe drejtuese e shkollës.

“Kopshtet e fëmijve janë proiritet i punës në njësinë administrative të Ksamilit, vuri në dukje znj. Oruçi. “Pavarësisht se periudha e verës krijon problematika të përditshme për menaxhimin e situatës turistike në një qytezë që disafishohet nga turistë vendas dhe të huaj, kjo nuk e bën administratën të kalojë në harresë disa problematika të evidentuara nga situatat në terrenin e kopshteve tona”, vijoi ajo.

Gjatë takimit në tryezën e përmendur më sipër me prezencë të prindërve të fëmijve dhe edukatoreve, u ngritën disa probleme dhe shqetësime për mbarëvajtjen e punës në kopshte. Si në drejtim të infrastrukturës ashtu edhe për rritjen e numrit të edukatoreve në kopshtin nr.1.

Sipas Administratores, problemi i lagështirës në kopshtin nr.2 dhe ndërhyja në infrastrukturën e këtij institucioni parashkollor, bëri të mundur që situata të shikohej nga një grup pune me prezencë të vetë kryetares së Bashkisë Sarandë znj. Florjana Koka. Ndjekja e problematikës në këtë kopsht të ngritur me të drejtë nga edukatorja e kopshtit Erisa Druckaj është në proces.

“Në kopshtin nr.2 i cili ka mjedis të jashtëm të bukur dhe të këndshëm për prindërit dhe fëmijët, jemi duke punuar që investimi i pritshëm të mundësojë më shumë tualete, shmangjen e lagështirës për t’i lenë vend dhe nevojës, që kopshtet e Ksamilit të jenë me ngrohje”, u shpreh Koka.

Nga informacioni që shoqata Ajmmi morri në Bashki, mendohet se punimet do të fillojnë së shpejti për t’ju siguruar një ambient komod të vegjëlve që do të frekuentojnë kopshtin gjatë muajve të ftohtë të dimrit.

Tryeza komunitare, e zhvilluar në muajin korrik, ngriti problematikat e konstatuara nga monitorimi i kopshteve, në prezencë të përfaqësuesve vendor, duke kërkuar të ndërhyet sa më parë. Pas 2 muajsh, duket se kemi një reagim nga Bashkia Sarandë, të cilët premtuan përmirësim të situatës në kopshtet e monitoruara.

POGRADEC

Nga diskutimet dhe problematikat që dolën gjatë takimit dhe monitorimeve, si dhe kalimin e kompetencave Bashkisë, janë bërë disa ndërhyrje në Kopshtin Persefoni Treni në Pogradec:

Sipas Drejtorit të Zyrës Arsimore Pogradec Ilir Torra, në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, edhe pse kompetecat i kalojnë bashkive, përsëri do të jepet ndihma e specializuar nga ana e Drejtorisë Arsimore. Do të vazhdohet të jepen ndihma edhe në trajnime me staf, me leksione dhe nevojat që do të kenë drejtueset e kopshteve.

Nga Ana e Bashkisë së Pogradecit në periudhën e verës është punuar në të gjitha kopshtet, kryesisht në lyerjet, rregullimet e ambienteve të brendshme dhe të jashtme. Megjithatë nevojat janë të mëdha për ndërhyrje, kjo për shkak edhe të amortizimit të ndërtesave, kështuqë Bashkia do të ketë në prioritet rikonstruksionin e plotë të tyre në muajt në vazhdim.

Në kopështin Persefoni Treni, sipas drejtoreshës Alketa Lufo, bashkia ka ndërhyrë në infrastrukurë, në shtrimin me pllakave të kopështit, madje dhe gjatë momenteve të monitorimit u gjet gjithë stafi i kopështit duke punuar në rregullimin e ambienteve. Sipas Lufos është e nevojshme shtimi i edukatoreve ndihmëse, për fëmijët me aftësi të kufizuara, po kështu edhe shtimi i pranisë së një psikologu. Kjo kërkesë e nevojshme për gjithë kopështet në Pogradec, pasi vetëm një psikologe është e pamundur për të përballuar gjithë kopështet dhe ngarkesën.

Po kështu, probleme janë daljet e emergjencës, kjo për shkak të ndërtesave të vjetra, oborret, krevatet etj.

Në grupin e parë 3-4 vjecc, këtë vit ka një numër më të vogël kërkesash për fëmijë, kjo dhe për shkak të emigrimeve të rinjëve. Sipas Enkeleida Kllomollari, Bashkia Pogradec, situata është vlerësuar nga stafi i bashkisë dhe bashkëpunimi me zyrën arsimore është i mirë, po kështu dhe këshilli i prindërve po vazhdon të ngrihet sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit. Po punohet edhe për situatën e dimrit e cila po afron, për faktin se Pogradeci është një bashki që temperaturat në dimër arrijnë deri në minus 15 gradë Celsius. “Kemi bërë edhe furnizimet me soba të reja dhe bazë materiale të nevojshme”, thotë Kollomari.

Ilir Torra, pohon se shtrimi i problematikave të kopshteve të Pogradecit, gjatë diskutimit të zhvilluar në muajt qershor, ishte një shtysë e mirë e cila drejtoi vëmendjen e të gjithë aktorëve në përmirësimin e kushteve të tyre.



Figura 1-Gjatë tranimit me prindër

Organizimi I tre forumeve me anëtarë të bordeve të kopshteve të Tiranës.

Forumi 1

Takimi u zhvillua në zyrat e shoqatës “Together for Life” më 27 Mars. Prindërit të cilët morën pjesë në takim, u informuan lidhur me standardet fizike dhe mënyrën e buxhetimit të kopshteve nga bashkia. Gjithashtu u fol mbi problematikat e dala nga monitorimi i standardeve fizike të kopshteve të Tiranës, duke u pajisur me njëkopje të raportit të publikuar. Lidhur me buxhetimin e kopshteve, u identifikuan prindërit të cilët së bashku me përfaqësues të shoqatës “Together for Life”, do të ndjekin mbledhjet e Këshillit bashkiak për të parë se si ky këshill do të veprojë lidhur me përmirësimin e standardeve fizike dhe buxhetimit të kopshteve.

Në fund të diskutimit, pjesëmarrësit u ftuan të bëhen pjesë e platformës online “Kopshtiim.al”, e cila ka për qëllim informimin dhe përfshirjen e qytetarëve në çështjet e qeverisjes vendore

dhe në veçanti të standardeve në edukimin parashkollor. Në takim morën pjesë 8 persona, ndër të cilët 7 femra dhe 1 mashkull.

Forumi 2

Takimi i dytë me prindërit anëtarë të bordeve të kopshteve të kopshtit numër 29 më 26 qershor. Në takim u diskutua mbi rolin e anëtarëve të bordit të prindërve dhe angazhimin e tyre për politikën lokale lidhur me arsimin parashkollor.

Gjatë takimit u fol me prindërit lidhur me funksionimin e bordit, rëndësinë e tij për të qenë një faktor ndryshues në situatën në të cilën ndodhen sot kopshtet e Tiranës. Prindërit pjesëmarrës u shprehën të gatshëm për të qenë bashkë me shoqatën “Together for Life”, të pranishëm në mbledhjet që zhvillon Këshilli Bashkiak i Tiranës për t’u informuar mbi buxhetimin e kopshteve, si dhe me punën që do të bëhet për përmirësimin e standardeve të kopshteve.

Në takim morën pjesë 6 persona. Të gjitha anëtarët e bordit të këtij kopshti ishin gra, si rrjedhojë të gjithë të pranishmit ishin gra. Dy personat e tjerë, anëtarë të jashtëm të bordit dhe anëtarë të administratës shtetërore nuk erdhën në këtë takim, pasi e konsideruan veten jashtë këtij bordi.

Forumi 3

Formi i tretë me prindër antarë të bordeve në kopshtet e Tiranës u zhvillua në ambientet e kopshtit Kodër Kamëz, më 29 qershor. Gjatë takimit u fol lidhur me mënyrën e funksionimit të bordeve sipas rregullores, rëndësinë e të qenit aktiv në vendimmarrje dhe të përfshirë në veprimtaritë e kopshtit në bashkëpunim me drejtuesit dhe mësueset, si dhe se si shoqata “Together for Life” nëpërmjet takimeve të vazhdueshme me antarët e bordit ka për qëllim të nxisë këtë bashkëpunim dhe përfshirjen e prindërve në proceset vendimmarrëse, sidomos kur bëhet fjalë për standardet dhe buxhetimin e kopshteve. Prindërit folën për rëndësinë që kanë këto takime në informimin dhe sensibilizimin e prindërve të tjerë. Në takim ishin të pranishëm 8 persona, femra.

Trajnimi me prindër

TFL trajnon prindërit e bordeve të kopshteve në Bashkisë Tiranë

Shoqata Together for Life zhvilloi trajnimin me prindër dhe anëtarë të bordeve nga disa kopshte të Bashkisë Tiranë. Ky trajnim kishte në fokus njohjen me të drejtën e informimit, procedurën dhe afatet ligjore dhe raste në praktikë se si prindërit mund të rrisin transparencën dhe përgjegjshmerinë e pushtetit vendor. Pjesë e këtij trajnimi ishte dhe njohja me përgjegjësitë ligjore që ka bashkia për të siguruar trajtim dhe edukim të fëmijëve në përputhje me standardet.

Trajnimi u mbajt nga eksperti Ligjor Andi Muratej, i cili theksoi për prindërit se “Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”. Duke i nxitur prindërit të kërkojnë

informacion mbi çështjet që prekin mirëfunksionimin e kopshteve që frekuentojnë fëmijët e tyre, Muratej trajnoi prindërit se si të plotësojnë dhe dërgojnë një kërkesë për informacion. Në takim morrën pjesë prindër nga kopshtet 31, 19, 25, 24, 6, 20 të cilët shprehën dëshirën të japin kontributin e tyre në përmirësimin e cilësisë të sistemit të arsimit parashkollor. Pas përfundimit të trajnimit, prindërit ngritën dhe disa çështje problematike si mungesa e sigurisë për ushqimin që konsumojnë fëmijët në kopshte, mungesën e hapësirës, si dhe mungesën e psikologut dhe mësueseve ndihmëse. Në trajnim morrën pjesë 10 persona ndër të cilët 2 meshkuj dhe 8 femra.



Figura 2-Gjatë trajnimit me prindër